



Pranimar / Dorezuar Primijsen/Prudato Received/Delivered	09. 11. 2020	viti god year	0
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2522/2020		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

Anr.266/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.266/2020 të datës 14.09.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████, me adresë në Prizren, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.11.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa numër A.nr.266/2020 e datës 14.09.2020 e parashtruar nga ankuesi ██████████.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.02-118-43165/1 i datës 01.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prizrenit dhe Vendimi Nr.01-116-62225 i datës 10.07.2020 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për Pezullim Parandalues me 50% të pagës për ankuesin ██████████.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit Ligjor”, në Zyrën Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit, bazuar në vendimin Nr.01-116-62225, të datës 10.07.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, është pezulluar nga puna me 50% të pagës së tij për shkak se kundër tij ka filluar procedura hetimore.

I pakënaqur me këtë vendim, me datë 08.08.2020 ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit. Me datë 26.08.2020, Zyra e Personelit të Komunës së Prizrenit njofton ankuesin se Komisioni për



Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është shuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë

Ankuesi, me datë 14.09.2020 përmes adresës zyrtare elektronik [ankesa.kpbsh@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpbsh@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e protokolluar me numër 1756/2020 datë 14.09.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kërkesën për përgjigje në ankesë e ka proceduar tek Komuna e Prizrenit më datën 16.09.2020, ku kjo e fundit me datë 16.10.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë dhe shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Bazuar në Nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin Nr.07/2020 të datës 26.10.2020 Këshilli ka vazhduar afatin e ankesës edhe për 10 ditë pune për shkak të specifikës së lëndës dhe në mungesë të provave nga punëdhënësi.

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër protokoll 1756/2020 të datës 14.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në forme elektronike (E-mail); Vendimin me Nr.01-116-62225 të datës 10.07.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit; Përgjigje e datës 25.08.2020; Vendimi nr.02-118-431651 i datës 01.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje ne ankesë e datë 16.10.2020 nr.protokoll 2137/2020;Vendim i datës 12.03.2018; Përgjigje e datës 08.07.2020 të Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda; Vendimi i datës 13.02.2020 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit për pezullim parandalues; Fletëkthese e datës 15.05.2020; Email zyrtar i datës 14.05.2020; Lista e pageve e leshuar nga data 01.02.2020 deri me datë 29.02.2020; Ankese e datës 03.08.2020 Vendim i datës 01.07.2020; Fletëkthese e datës 03.07.2020; Fletëkthese e datës 16.07.2020; Akte evndim i datës 22.03.2019; E-mail i datës 17.07.2020; Njoftim nr.569 i datës 17.07.2020 lëshuar nga Drejtori i DASHC-së; vendimi per vazhdim te afatit i datës 26.10.2020; **Provat shtesë** nga Komuna e Prizrenit të datës 05.11.2020 me nr.protokoll 2456/2020; Kërkesa e datës 28.10.2020 Prokurorisë Themelore në Prizren; Kërkesa e datës 28.10.2020 drejtuar Gjykates Themelore në Prizren; Përgjigje e datës 01.11.2020 nga Gjykata Themelore në Prizrenë; Aktevendim nr .PP/I nr.3/20 i datës 17.01.2020 për fillimin e hetimeve; Aktevendimi i datës 14.02.2020 Ppr.04/2020; Shkresat e Policisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore te ankuesit *janë të pabazuara, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të ofruara nga palët, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit me vendim Nr.01-118-1967 te datës 13.02.2020 ka pezulluar nga puna me 50 % të pagës ankuesin ██████████ ██████████, me arsyetim se ankuesi ka munguar nga puna për disa ditë dhe se bazuar në informata jo zyrtare ndaj ti ka filluar hetim penal. Nga shkresat e lëndës, nuk është vërtetuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit ka qenë i njoftuar zyrtarisht nga Prokuroria Themelore në Prizren për fillimin e hetimeve dhe paraburgimin e ankuesit si i punësuar panë kësaj komune.

Ankuesi, sipas fletëpranimit vendimin për pezullim Nr.01-118-1967 të datës 13.02.2020 e ka pranuar me datë 15.05.2020, ku i pakënaqur më këtë vendim, me datë 03.06.2020 parashtroi ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZAK) të Komunës së Prizrenit. Ky i fundit me Vendim Nr. protokoll Nr.02-118-43165/1 të datës 01.07.2020, ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje te Kryetari i Komunës së Prizrenit.

Pas vendimit të KZKA-së dhe njoftimit zyrtar të datës 08.07.2020 të Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i Komunës së Prizrenit, nxjerr vendimi Nr.01-116-62225 datë 10.07.2020, me të cilin ankuesin e pezullon nga puna me 50% të pagës së tij për shkak se kundër tij ka filluar procedura hetimore.

Sipas shkresave të Prokurorisë Themelore dhe Gjykatës Themelore në Prizren- Departamenti për Krime të Rënda, Kolegji konstatoi se Prokuroria Themelore në Prizren ka filluar hetim penal kundër ankuesit me aktvendim Ppr.nr.03/2020 të datës 08.01.2020 për shkak të dyshimit për kryerje të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 442 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 dhe 2.2, lidhur me neni 31 të Kodit Penal. Ankuesi me aktvendimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.4/2020 të datës 17.01.2020, ka qenë në paraburgim nga 16.01 deri me 15.02.2020, ndërsa nga data 14.02 deri 05.03.2020 në arrest shtëpiak bazuar në aktvendimin Ppr.nr.04/2020 të datës 14.02.2020.

Kolegji, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sipas ankesës nr.266/2020 të datës 14.09.2020, me të cilin kërkon që të anulohet vendimi për pezullim i Kryetarit të Prizrenit Nr.01-116-62225 i datës 10.07.2020, për arsye se është i pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin, pasi që ndaj ankuesit është zhvilluar vetëm procedura hetimore parapenale dhe nuk ka ngritje të aktakuzës.

Kolegji për vendosje të ankesës, konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar, për faktin se procedura penale konsiderohet se ka filluar me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6, 102 dhe 104 të Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale. Pra, Kolegji konstaton se ndaj ankuesit ka filluar procedura penale sipas aktvendimit mbi fillimin e hetimeve të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Krimeve të Rënda Ppr.nr.03/2020 të datës 09.01.2020 dhe se ankuesi nga data 16.01 deri me 15.02.2020 ka qenë fillimisht në paraburgim, ndërsa nga data 14.02 deri 05.03.2020 në arrest shtëpiak, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit konsiderohet i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prizrenit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. protokoll Nr.02-118-431651 të datës 01.07.2020 sipas ankesës së ankuesit të datës 03.06.2020 Nr.01-118-1967 e ushtruar kundër vendimit Nr.01-118-1967 të datës 13.02.2020, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me Ligjin për Shërbim Civil dhe Ligjin Nr. 06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji, pas analizimit të lëndës në pikëpamje të provueshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit Nr.01-116-62225 të datës 10.07.2020 për pezullim parandalues me 50% të pagës të ankuesit, gjënë se ky vendim është në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 si dhe

paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjykimit;..... 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Nga ajo që u tha më lartë, e bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr./L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr.266/2020**

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit ██████████
- Kryetarit të Komunës në Prizrenit,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.